REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2270/3 prot.

Tepelenë, më 22.07.2026

VENDIM

Nr. 53, datë 20.07.2026

"Për miratim të kërkesës, për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik "Në përdorim të Bashkisë Tepelenë" me numër pasurie 66/2, 291, 318 dhe 338 ZK2404 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 485 sipas VKM nr. 386 datë 25.5.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kurvelesh të Qarkut të Gjirokastrës" fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)".

Në mbështetje të nenit 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor" dhe të nenit 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"; ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 54, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"; neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", neni 3 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara"; Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit", Udhëzimin nr.3 datë 18.07.2002 "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësite e Qeverisjes Vendore" dhe VKM nr.500 datë 14.08.2001 "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore"; Kërkesave numër protokolli 1169 datë 15.06.2026 të z. Osman Çulli dhe numër ekstra datë 11.05.2026 të Këshillit Bashkiak Tepelenë për shqyrtim kërkese për "Kërkesë për vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Tepelenë" për heqjen e të drejtës së përdorimit të Bashkisë Tepelenë të pasurisë nr.66/2, 291, 318 dhe 338 ZK2404 me qëllim lënien në dispozicion për vazhdimin e procedurës për regjistrimin në pronësi sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr.314 datë 14.12.1991.

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurës për të kërkuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Gjirokastër ç'regjistrimin nga kartela e pasurisë për sipërfaqet me numër pasurie nr.66/2, 291, 318 dhe 338 ZK2404 sipas planvendosjeve bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim lënien në dispozicion për vazhdimin e procedurës për kalimin në pronësi të Z. Osman Çulli sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr.314 datë 14.12.1991.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespodencës ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Zhvillimit Rural.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12 (dymbëdhjetë)vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 22.07.2026

NË MUNGESË ME POROSI

N/KRYETAR MJAFTONI ZERAJ